

Takimi i 11 online i projektit SINCERE

Në kuadër të projektit Erasmus+ CBHE “SINCERE – Strengthening Integrity and Ethical Culture in Regional Higher Education”, u zhvillua ditën e martë (datë 5.5.2026), Takimi i 11-të Koordinues Online me pjesëmarrjen e partnerëve të projektit.

Takimi u fokusua në ecurinë e paketave të punës WP2, WP3 dhe WP4, duke diskutuar mbi përgatitjen e Draftit të Kornizës së Integritetit Akademik, analizën e pyetësorëve dhe afatet drejt dorëzimit të dokumenteve të projektit. Gjithashtu, u diskutua mbi organizimin e takimeve konsultuese me grupet e interesit për marrjen e mendimeve dhe vlerësimin e draftit, si edhe ecuria e punës për hartimin e moduleve trajnuese nga UVT dhe UNKO.

Në kuadër të WP3, kërkesat teknike për platformën monitoruese me inteligjencë artificiale si dhe përgatitjet për nisjen e aktiviteteve të kësaj pakete pune u paraqitën nga specialiste të UBT (University of Business and Technology i Prishtinës), si partneri përgjegjës për Paketën e Punës 3 (WP3).

Koordinatori i projektit evidentoi rëndësinë e intensifikimit të aktiviteteve të publikimit dhe promovimit të rezultateve të arritura gjatë vitit të parë të zbatimit të projektit. Në këtë kuadër, partnerët e konsorciumit ranë dakord që secili institucion të organizojë gjatë muajit maj një aktivitet të brendshëm informues, me qëllim prezantimin e objektivave, aktiviteteve dhe rezultateve të deritanishme të projektit.

Takimi përfshiu edhe diskutime mbi hapat e ardhshëm të projektit, formalizimin e rrjetit RAIN, përfshirjen e partnerëve afrikanë, menaxhimin e risqeve të mundshme si dhe konfirmimin e datës së takimit të ardhshëm.

